



UN
DP



FUQIA JONË ËSHTË KUJDESI - FOKUSI JENI JU!

ASISTENCE SHTEPIAKE

Fuqizimi i personave

Rezultate

Qendra ASET ofroi asistencë shtëpiake për mëkernbjen e 30 individëve më vulnerabël të prekur nga tërmeti i Nëntorit 2019. Punonjësi social dhe psikologu ofruan shërbimin duke i asistuar personat në nevojë me shërbime përkujdesi në banesë, mbështetje psiko-soicale dhe asistencë për shërbime shendetësore. Paketat mbështetëse u dhanë sipas nevojave të pëfituesve të shërbimit dhe janë hartuar në bashkëpunim me cdo përfitues që u asistua, duke përfshirë shoqërimin, kujdesin në banesë, mbështetje psiko/sociale, bisedat dhe qëndrimi pranë tyre, apo lidhje dhe suport me shërbime të tjera në komunitet.

Shërbime

30 persona patën mundësinë e marrjes së shërbimeve sociale, cilësore, nga figura profesionale, në bazë të nevojave që paraqitej nga grupmosha, gjinia dhe kushtet social-ekonomike, shërbime të cilat u ofruan pranë vendbanimit në banesë si dhe u mbështeten në aspektin psiko-social. Kjo minimizoi rrezikun e përjashtimit social dhe diskriminimit.



Suport financiar

Bazuar në planin e ndërnyrjeve specifike pas vlersimeve rast pas rasti për 30 personat e identifikuar dhe të suportuar me këshillime psikosociale ose me shërbime të tjera të nevojshme përfituesit u ndihmuan edhe me paketa ushqimore ose pajisje elektroshtëpiake sipas nevojës.

Rritje kapacitetesh

18 studentë të Fakultetit të Shkencave Sociale u trajnuan jo vetëm për shërbimin për Asistencën Shtëpiake por edhe për të qënë pjesë e një grupi vullnetarizmi për të ofruar shërbime komunitare ndaj grupeve vulnerable.

Gjendja e familjes para nderhyrjes

Shtëpia e z.LP është në gjendje shumë të keqe dhe e pa banueshme e vlersuar nga DSM5. Jetonin në shtëpi e cilësuar e pabanuar nga vlerësimi, por njëkohësisht marrin qeranë e paguar nga Bashkia Durrës. Gjendja e shtëpisë është shumë e keqe e pa përshtatshme dhe e pasigurtë për të jetuar.

Jetojnë në kushte të vërshtira ekonomike me bashkëshorten dhe me vajzën 12 vjec. Vajza ndjek klasën e gjashtë. Dy vajzat e tjera të martuara jetojnë në Durrës dhe ndihmojnë sa kanë mundësi herë pas here por janë të kufizuara nga gjendje jo e mirë ekonomike dhe ato. Zonja LP ka dy vjet që ka thyer këmbën, dhe ka kryer edhe operacion për këmbën por pas operacionit e ka të vështirë të lëvizë, dhe të kujdeset për shtëpinë.

Gjiithashtu zonja ka probleme shendetësore dhe sëmundje bashkë shoqëruese. Kurse Z. LP kishte probleme me shikimin dhe për këtë arsye nuk i ishte rinovuar as patentat dhe kjo ka bërë që ai të ngelet i pa punë. Asnjë nga bashkëshortët nuk kishte pension pasi bashkëshortja nuk kishte qënë kurrë në mardhënie punësimi pasi

ishite kujdesur për rritjen e fëmijëve. Bashkëshorti ka punuar si shofer por nuk ka arritur akoma moshën e pensionit dhe për këtë arsye për momentin që u kontaktuan ishin të dy pa asnjë të ardhur.

Familja jeton me një varfëri kronike dhe ekstreme. Aktualisht nuk ka pension as kryefamiljari dhe as zonja e cila ka qënë gjithmonë shtëpiake. Të vetmet të ardhura përvec qerasë që paguan Bashkia Durrës janë të ardhura të limituara nga djali i cili jeton jashtë por nuk ndihmon vazhdimisht familjen pasi puna e tij nuk është e qëndrueshme për shkak të problemeve me dokumentacionin.

Vetëm kur ai ka mundësi dërgon sasi të pakta të ardhurash. Pranë shtëpisë kanë sipërfaqe të vogël

toke ku kanë disa pemë frutore të cilat i përdorin vetëm për nevoja familjare por që janë të pakëta dhe nuk janë për tu tregëtuar. Nuk kanë kafshë shtëpiake pasi kryefamiljari ka qënë i angazhuar me punë si shofer dhe gruaja për shkak të problemeve fizike nuk mund të kujdesej. Aktualisht asnjë nga familja nuk punon. Kryefamiljari për shkak të problemeve me shikimin për shkak të një perdeje nuk mund të punojë më si shofer. Bashkëshortja ka probleme lëvizje për shkak të thyerjes së këmbës. Vajza është minorene dhe ndjek shkollën.



Asistenca ndaj familjes LP

Për të ofruar fuqizim të familjes së pari u fokusuar në aspektin shëndetësor. Asnjëri prej antarëve të familjes nuk ishte paisur me kartë shëndeti dhe kjo i kufizonte në marrjen e kujdesit shëndetësor dhe ekzaminimeve të tjera të cilat privatisht nuk mund ti përballonin në klinika private për shkak të pamundësisë ekonomike. Për këtë arsye punonjësja sociale morri kontakte direkt me drejtorin e Qendres Shëndetësore dhe morrëm karta shëndeti për të dy bashkëshortët. Më pas për secilin prej tyre u caktuan vizita dhe konsulta në bazë të problemeve specifike. Punonjësi social ka qënë pranë tyre dhe ka ndjekur ecurinë e tyre vizitë pas vizite. Për të fuqizuar kryefamiljarin i cili kishte

probleme me perden e syrit u trajtua shikimi i tij në mjek okulist dhe u bënë ndërhyrjet e nevojshme për të riparuar shikimin e tij. Pas heqjes së perdes kryefamiljari mund të ri punësohet si shofer dhe në këtë mënyrë ka mundësi për të rritur të ardhurat për familjen e tij.

Edhe bashkëshortja e asistua për konsulta të njëpasnjëshme gjinekologjike për të trajtuar problemet që e shqetësonin dhe për të u arrit mirqënie shëndetësore.

Përvec suportit për të aksesuar shërbime shëndetësore familja LP u mbështet edhe me keshillim psiko-social si edhe me pako ushqimore

duke qënë se situata aktuale ekonomike ishte shumë e vështirë.

Për kryefamiljarin pas ekzaminimeve të syrit u përpoqëm që të ndërmjetësonim për të rifilluar punë dhe jemi ende duke kërkuar mundësi. Në këtë mënyrë familja fuqizohet pasi rriten të ardhurat për të përballuar jetesën.





Ku mund te drejtohem per Asistence Shtepiake?

Nese ju ose nje i aferm tuaj i moshuar qe jeton i vetem dhe ka
nevoje per aistance shtepiake ju mund te aplikoni prane Qendres
ASET ne imailin zyrtar te saj.



Publisher Plus

<http://www.pearlmountainsoft.com/publisherplus>

Email: info@asetcenter.al

website: www.asetcenter.al